

V E N D I M N R 2

ASAMBLESE SË ORTAKËVE TË SHOQËRISË

Sot, më datën 04.06.2021, Ne, ortakët e shoqërisë “SKYTON DEVELOPMENT” SH.P.K., Z.George ANDREWS me 50 % të kuotave të kapitalit të kësaj shoqërie dhe Z. Frank FAZIO, me 50 % të kuotave të kapitalit të kësaj shoqërie, morëm në shqyrtim çështjet si më poshtë:

Duke qënë se Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “SKYTON DEVELOPMENT” SH.P.K., ka më shumë se një vit që nuk po zhvillon aktivitet, në mbledhjen e kësaj date, ne ortakët e kësaj shoqërie, pasi studiuam gjendjen e bilancit të shoqërisë të datës 31.12.2020, si dhe dokumenta të tjera të shoqërisë, mbështetur në aktin e themelimit & statutin e shoqërisë si dhe në Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare” dhe në Ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”

V E N D O S Ë M

1. Të fillojmë procedurat për likuidimin vullnetar të shoqërisë “SKYTON DEVELOPMENT” SH.P.K. me NUIS L81925009P dhe adresë: Njësia Bashkiake Nr.2, Rruga” Themistokli Gërmenji”, Pallati Pegaso, Kati 7, Zyra Nr.30;
2. Të emërojmë Likuidator të Shoqërisë, Znj. Elida MITI, Audituese Ligjore, me numër liçence Nr.201, Datë 04.10.2010 (më poshtë e quajtur likuidatori), shtetase shqiptare, lindur në Vlorë, Shqipëri, më 22.03.1966, mbajtëse e kartës së identitetit me numër personal G65322148J, një kopje e së cilës është bashkalidhur;
Likuidatori do të ndjekë të gjitha masat e nevojshme dhe procedurat e parashikuara nga nenet 191-203 të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, i ndryshuar, “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare” i Republikës së Shqipërisë si dhe çdo kërkesë tjetër ligjore;
3. Autorizohet Likuidatori, ose personi i autorizuar prej saj, Znjsh.Livia Berberi, mbajtëse e kartës së identitetit me numër personal J75925049C, një kopje e së cilës është bashkalidhur, të paraqesë në QKB këtë Vendim si dhe çdo dokument tjetër të nevojshëm për procedurat e likuidimit.
Ky autorizim është i vlefshëm edhe për çdo strukturë tjetër shtetërore, që mund të nevojitet për t’u kontaktuar, me qëllim likuidimin e shoqërisë;
4. Të njoftohet dhe të dërgohet në QKB gjithë informacioni i kërkuar, modelet e firmës, të drejtat dhe detyrimet e likuidatorit të Shoqërisë;
5. Duke mos patur çështje të tjera, mbledhja deklarohet e mbyllur.


ORTAKËT

George ANDREWS



SKYTON DEVELOPMENT
L81925009P

Frank FAZIO



Adresa: Njësia Bashkiake Nr.2, Rruga”Themistokli Gërmenji”, Pallati Pegaso, Kati 7,
Zyra Nr.30, Tiranee, Albania.

e-mail: Skytondevelopment.al@outlook.com

Elida Miti
